

FILLIMI I SHKOLLËS NË RRETHIN E HEILBRONN-IT FËMIJË/TË RINJ 6 – 18 VJEÇ PA NJOHURI TË MJAFTUESHME TË GJERMANISHTES

ALBANISCH

MËSIMI I GJERMANISHTES NË SHKOLLË

Për fëmijët dhe të rinjtë e moshës 6 deri në 18 vjeç frekuentimi i shkollës është i detyrueshëm në Gjermani. Asnjë fëmijë nuk duhet të mungojë nga shkolla pa justifikim. Fëmijët dhe të rinjtë që nuk flasin gjermanisht apo që nuk e flasin mjaftueshëm gjermanishten zakonisht frekuentojnë një Vorbereitungsklasse (VLK, klasë përgatitore) në fillim. Aty mësojnë gjermanisht së bashku me fëmijët e tjetër emigrantë dhe kalojnë në klasën e rregullt maksimumi pas dy viteve. Si rregull fëmijët mbi 10 vjeç që nuk e njohin alfabetin latin frekuentojnë dhe një klasë alfabetizimi.

FËMIJËT 6 – 9 VJEÇ

Ju lutemi, regjistroni fëmijën në Grundschule (shkollën fillore) të vendbanimit tuaj. Emrin dhe adresën e shkollë mund ta merrni pranë bashkisë. Shkolla do t'ju këshillojë gjithnjë për mundësitë e një klase përgatitore. Nëse nuk e flisni mjaftueshëm gjermanishten, shkolla mund të marrë përkthyes vullnetarë (prindër mentorë) për regjistrim ose konsulencë shkollore. Në këtë rast, jeni të lutur ta informoni shkollën në kohë.

FËMIJËT 10 – 14 VJEÇ

Për fëmijët nga 10 deri në 14 vjeç pa njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes, zgjidhen shkolla të përshtatshme (Werkreal-, Real-, Gemeinschaftsschule, Gymnasium – shkolla profesionale, të përgjithshme, gjimnaz) me Vorbereitungsklasse (VKL, klasë përgatitore) pranë vendbanimit të tyre. Bashkërendimi i arsimit nga këshilli i rrethit i fton nxënësit të kryejnë një test vendosjeje për matematikë dhe anglisht. Ky test nuk ka vlerësim me notë. Kontrollohet vetëm niveli i njohurive të fëmijëve për të zgjedhur një shkollë të përshtatshme. Informacione të mëtejshme do të merrni në ditën e testit të vendosjes.

➔ Në rast arritjesh të mira akademike fëmijët mund të vijojnë me deri te dëftesa e dëshiruar arsimore (p.sh. Abitur – e shkollës së mesme).

Nëse nuk e merrni ftesën për test brenda 4 javëve pas regjistrimit në bashki, jeni të lutur të regjistroheni!

Personat e kontaktit:

Anja Löhe, Tel. 07131 994-8472, anja.loehe@landratsamt-heilbronn.de,

Andrea Theobold, Tel. 07131 994-8473, andrea.theobold@landratsamt-heilbronn.de

TË RINJ 15 – 18 VJEÇ

Të rinjtë e moshës shkollore 15 deri në 18 vjeç kontaktohen zakonisht me letër nga drejtori i përgjithshëm i shkollave profesionale pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të banorëve.

Në vijim do të vendosen në një program të përshtatshëm arsimor me mundësinë për të mësuar gjermanisht. Si rregull, ata fillojnë në "Vorbereitungsjahr Arbeit/Beruf ohne Deutschkenntnisse" (VABO, punë/profesion viti përgatitor pa njohuri të gjermanishtes).

Në rast arritjesh të mira, nxënësit mund të marrin të gjitha dëftesat e shkollës në kurset e arsimit të mëtejshëm sipas VABO. Nëse nuk e merrni letrën brenda katër javëve nga regjistrimi në bashki, kontaktoni me znj. Hettler, Andreas-Schneider-Schule Heilbronn, Tel. 07131 928-110, alexandra.hettler@ass-hn.de.

INFORMACION PËR NXËNËS TË ARDHSHËM

Informacione të përgjithshme për studimet në Gjermani: <https://www.study-in-germany.de/de/>